

DRAGO JANČAR  
**DHE DASHURIA, GJITHASHTU**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



DRAGO JANČAR

DHE DASHURIA, GJITHASHTU

roman

Përktheu nga origjinali sllovenisht

Nikollë Berishaj

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2022

Autori: Drago Jančar (Drago Jançar)  
Titulli në origjinal: In ljubezen tudi  
Botoi në sllovenisht: Beletrina



Me bashkëfinancimin e Programit  
“Europa Krijuese” të Komisionit Europian.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo  
Redaktore: Besa Vila  
Korrektore letrare: Majlinda Bami  
Përkujdesja grafike: Edona Marku  
© e imazhit në kopertinë: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-348-82-1

Drago Jančar, 2017  
© *në shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi  
me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim  
të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA  
Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë  
Tel.: + 355 4 22 40 116  
Email: botimet.toena@gmail.com  
toena.porosionline@gmail.com  
www.toena.al

## KAPITULLI I PARË

Vajza nga fotografia



## 1.

Në foton që shkrepri një fotograf i panjohur shihen dy vajza belholla: e para veshur me një fund me kuadrate, me xhup të lehtë dhe me çorape të errëta, ndërsa tjetra me një pallto të zezë elegante dhe me gërshta të thurur bukur, që i bien përmbi shpinë, por pa çorape, që të lë të kuptosh se jemi në frymëmarrjet e fundit të verës së ngrohtë; ndoshta në ditët e para të shtatorit. Fotografi e shkrepur një paradite, me qytetarë, që vrapojnë drejt punëve të tyre, femra me çanta, e disa të tjerë vetëm shëtisin si të papunë. Këtu shihet edhe mashkulli me biçikletë, që bisedon me dikë, me siguri për kohën, një tjetër thith cigaren dhe fryn tymin në ditën e qetë të Zotit. Një shikues i kujdesshëm mund të vërejë se në tabelën e madhe ka ndryshuar emërtimi i hotelit: hotel “Orel” është ndryshuar në hotel “Adler”; me sa duket pronari praktik ka kërkuar një ndryshim të vogël dhe ka porositur të punohen vetëm dy shkronja të reja, A dhe D, ndërsa fjalën *Restavracija* e ka shndërruar në *Restaurant*. Poshtë këndit të djathtë të fotos, jo me pamje ballore, por me shpinë, ecën njeriu me uniformë: me çizme të zeza, me xhakët të hirtë ushtarake, me revole në brez. Pamja idilike e një paraditeje të hershme

të vjeshtës, në një rrugë të Mariborit, që papritmas shndërrohet në një çast të padukshëm tensioni: prej kah vjen, kah shkon burri me uniformë, që pa dyshim është uniforma e pjesëtarëve të njësive *Schutzsaffel*, i panjohuri futet nga skaji i fotografisë dhe shkon drejt thellësisë së saj. Vetëm në shikim të parë duket i panjohur, sepse vajza flokëverdhe, me fundin me kuadrate dhe me çorape të zeza, kthehet drejt burrit me uniformë dhe i thotë shoqes së vet:

- A nuk po i përngjan ky krejtësisht Ludekut?

Shoqja e saj me gërsheta e sheh në momentin e fundit oficerin gjerman në parakalim.

- Më duket se mund të jetë ai, - thotë. - Duket pak më i rritur, - dhe qesh.

Por shpejt, kur sheh fytyrën e shoqes së vet, bëhet serioze.

Fytyra e vajzës me fundin me kuadrate dhe me çorape të zeza duket e shqetësuar, diçka e mundon, ndoshta për këtë ka folur me shoqen e saj dhe në moment mbizotërohet nga siguria.

- Ai është, - thotë, - e njoh.

Shikon për pak në drejtim të tij.

- Mendon se duhet t'ia them? - pyet vajza, me fundin me kuadrate, me një zë të shqetësuar, gati-gati të dridhur.

- Po të isha në vendin tënd, do t'ia thosha, - e nxit me tundje koke dhe me ngritje supesh shoqja me gërsheta.

- E, çka po të kushton?

Vajza me fundin me kuadrate lëviz me nervozizëm.

- Do t'i lutem babait të flasë me të, ai e njeh mirë.

Dhe pas disa çasteve shton:

- Nëse pranon.
- Sonja! - thërret shoqja dhe qesh paksa me ngucje.
- Unë mendoj se më mirë do të ishte po t'ia thoshe ti.

Kjo buzëqeshje ishte e tepërt, nuk i nevojitej Sonjës që e shtrëngonte me duar çantën, nuk i dukej qesharake, madje as për të buzëqeshur nuk ishte, ndonëse së shpejti do t'i duhej të buzëqeshë.

Burri me uniformë, me hapat e tij të vendosur, tani është në thellësi të fotografisë, diku kah fundi i rrugës, që tani quhet “Burggasse”.

- Të bëhet ç'të bëhet, - tha papritmas vajza me flokë të verdhë dhe me fundin me kuadrate, që e shtrëngoi edhe më shumë çantën dhe vrapoi pas oficerit. Sado shpejt të ecte, nuk do ta arrinte, prandaj vrapoi.

## 2.

E shoh se si vrapon pas burrit me uniformë nëpër trotuar pranë dritareve të kafenesë “Astoria” në rrugën “Sllovene”, siç quhej para disa vitesh dhe më herët akoma, shumë vite më parë kur ishte këtu Austria quhej rruga “Windischsstrasse”, ndërsa tani quhet “Burggasse”. Vraponte pas oficerit gjerman dhe i afrohej gjithnjë e më shumë. Për një çast e humb nga shikimi, oficeri merr drejtimin përpjetë nëpër “Tyrsheva”, siç quhej para disa vitesh, por tani quhet “Herrengasse”. Vajza me fundin me kuadrate, Sonja, ndalon në qoshe, merr frymë thellë dhe e shikon. Duket se ka ndryshuar mendim; nuk mund ta ndalte. Por i duhet, një shpresë i thoshte se këtë duhet ta bëjë. Një çast më vonë vendos dhe futet përpjetë nëpër rrugë. Arrin të ecë gati krahas

tij, provon të marrë frymë lirisht, nuk dëshiron që ai ta shohë me dihatje, dëshiron të duket se është duke shëtitur, se po shkon drejt parkut, apo se po shkonte në të njëjtin drejtim, por për punët e veta. Ecën pothuaj krahas tij, ndoshta një hap pas, por sërish është e pavendosur; a t'i flasë, ndoshta nuk guxon. Zemra fillon t'i rrahë më shpejt. Pastaj e parakalon me hapa të shpejtuar, kthehet drejt tij, a thua se e kish parë veç në këtë moment dhe i thotë:

- Ti je Ludeku, apo jo.

Oficeri kthehet drejt saj.

- Nuk të kujtohem? - buzëqesh vajza me fundin me kuadrate, sepse i duhet të buzëqeshë.

Burri ndalet, e mat me shikim, duket se nuk e njeh.

- Vërtet nuk më njeh? - thotë vajza dhe e shtrëngon edhe më shumë çantën në kraharor, - unë jam Sonja.

- Çka dëshironi? - thotë oficeri në gjermanisht me një zë të pakëndshëm, të prerë dhe i ngul një shikim, ku prapëseprapë shihet një kuriozitet, ndoshta edhe i duket e njohur.

Edhe Sonja e di gjermanishten, për të gjermanishtja nuk është e vështirë, e ka mësuar në gjimnaz, përndryshe do ta dinte se në këtë qytet tani flitet vetëm gjermanisht, megjithatë ajo i foli sllovenisht dhe për këtë arsye u vu në një siklet të vogël. Bile, me ushtarin me uniformë gjermane, me oficerin që dëshiron ta lusë për diçka. Biseda mund të ndërpritej menjëherë, para se të fillonte, ndonëse edhe Ludeku e di sllovenishten dhe Sonja e di këtë mirë; para nja pesëmbëdhjetë vjetësh, atëherë kur ishte një vajzë e vogël, ai fliste sllovenisht.

- Në Pohorje ishim së bashku në ski, - shpërthen Sonja në gjermanisht, - atëbotë kishit një pulovër të

kaltër, - fillon t'i drejtohet me ju, pamja e tij është e tillë, zëri i tij është i tillë që nuk mund t'i thoshte: ti, Ludek. - Zotëria kishte një pulovër të kaltër, - vazhdon me nxitim dhe me dihatje dhe ndërkohë edhe buzëqesh, - me një vijë të bardhë përkrye... me babain tim njiheshit, ai quhet Anton, Anton Belak... me siguri që i kujtoheni... njëherë ishim bashkë në ski, më ngritët se isha rrëzuar në borë, isha e tëra e lagur... borë e lagur.

Të gjitha këto i flet me një frymë dhe e shikon me një shpresë.

Oficerit i ndërmendet diçka, posa dëgjoji emrin e babait së vajzës diçka iu zbardh, por dukej se këtë nuk dëshironte ta dinte, atëbotë vërtet e quanin Ludek, por tani është Ludvig, gjithmonë ishte Ludvig, por vetëm e thërrisnin ashtu, me atë shtrembërim slloven.

E shikon, një çast, fillon të buzëqeshë.

- Po, vërtet ishim në ski atje lart, po, vërtet bënim ski.

- Dhe unë u rrëzova në borë.

- U rrëzuat në borë?

- Dhe ju më ngritët. Isha krejtësisht e lagur, njërin shkop e kisha tretur.

- Shkopin?

- Shkopin e skisë, e kërkuam në borë.

Ludvigu shikon orën.

- E babai? - pyet. - Si është babai?

Nuk pret përgjigje, ngutet, kryen detyrë me përgjegjësi në atë qytet, detyrë me përgjegjësi të madhe, nuk mund të qëndrojë pa kufi në rrugët e Mariborit dhe të flasë me vajzën, të cilën dikur, duket, e kishte ngritur të lagur nga bora, ndoshta edhe shkopin e saj të skisë; shikon orën dhe thotë se po e priste detyra. Por,

mendon, se vajza tani është rritur e bërë femër dhe me plot dëshirë do ta ngrinte sërish nga bora.

- Po, pas punës? - tha Sonja dhe e ndjeu se faqet i ishin skuqur. - Pas punës, ndoshta, do të mund të pinim një çaj bashkë? Në kafene?

E shikon i çuditur, dhe disi me mosbesim. Ai është në një detyrë të tillë, që pas një propozimi të tillë bëhet paksa mosbesues.

- Babai ka farë problemi? - e pyeti drejtpërdrejt, sepse i duket se me atë çaj është i lidhur ndonjë problem, për të cilin vajza dëshiron të flasë.

- Jo babai, - thotë qetë Sonja.

- Nëse është diçka zyrtare, ejani në zyrën time, - tha Ludvigu, përshëndet me respekt me tundje koke dhe vazhdon rrugën e vet.

Sonja mbetet pa fjalë dhe ul shikimin në tokë. Çantën e shtrëngoi me aq fuqi, saqë lëkura e gjymtyrëve i mori ngjyrë të bardhë. Mund të shkonte pas tij, mund të thoshte se do ta bëjnë bashkë një pjesë të rrugës. Por nuk mundi, këtë nuk mundi ta bënte, bëri çka ishte e mundur. Ndaloj dhe shikoi në drejtimin e tij.

- Vetëm një çaj, - thirri, pa e ditur as vetë prej kah e mori fuqinë për atë nënçmim. Që ta luste në rrugë oficerin gjerman për një takim. Edhe pse ky ishte vetëm Ludeku, skiatori Ludek i fëmijërisë së saj. Iu desh t'i duronte shikimet domethënëse të njerëzve që kalonin andej dhe ta duronte buzëqeshjen e tij mëshiruese. Kur u kthye, ndali hapin e vet të vendosur dhe tha:

- Në rregull. Nesër pas dite jam i lirë. Në orën pesë në "Theresienhof". Dhe nuk jam kurrfarë Ludeku. Emrin e kam Ludvig.

Sonja tundi kokën, ndali në mes të rrugës dhe shikoi krahët e tij të gjerë, çizmet e zeza, ecjen e vendosur të Ludvig Mishkolnigut, që ecte me çizmet e zeza dhe me uniformën e SS-ve drejt detyrave të veta të rënda. E di ku është “Theresienhof”-i, para disa vitesh ishte Kafeneja e Madhe, e tani aty mblidhen oficerët gjermanë, ndërsa femrat, si Sonja, nuk shkojnë atje, ndonëse asaj i duhet të shkojë.

### 3.

- Gjermanishtja juaj, - tha Ludvig Mishkolnigu, ndërsa po ndizte cigaren, - gjermanishtja juaj është e jashtëzakonshme.

Tani është i veshur me kostum civil, elegant, të mbyllur, me vija të holla të kaltra. Sonjës i duket tashmë shumë më i ngjashëm me atë Ludekun e dikurshëm që njihnte ajo.

- Pse më drejtoheni me ju, nuk ka nevojë për këtë, njihemi aq gjatë.

Sonja dëshironte të fliste me të, sikur njihen prej shumë kohësh, dhe vërtet njiheshin, ndonëse atij, ndoshta, vetëm kalimthi i kujtohet.

- Po, e vërtetë, - tha Ludvigu. - Kur të nxora nga bora, atje në Pohorje, ishe një çupëz e vogël.

- Jo krejt e vogël, ndoshta një dymbëdhjetë vjet i kisha. Por më kujtohet gjithçka fort mirë. Të rriturit pinin verë të zier, ndërsa ne fëmijët hanim biskota, i kishte sjellë nëna me vete.

- Verë të zier, vërtet.

Frynte në ajër një re nga tymi i duhanit që shndërrohet përmbi kokën e tij në një rreth vezullues. Me kënaqësi e shikon prodhimin e vet të tymit të kaltër, edhe Sonja e shikoi, do të qeshte, po të mos ishte situata aq serioze, ndoshta do të ishte mirë të buzëqeshte pakëz, qoftë edhe me dhunë. Qeshi.

- Si e bën këtë? - e pyeti me një shikim të çuditshëm. Ah, vetëm shtiret se po e admiron këtë re tymi të shfryrë, ndonëse nuk i intereson aspak. Mundohet ta shikojë me admirim në sy, por nuk ka sukses, sytë e tij kanë një nuancë të gjelbër, të ftohtë.

- Do ta provosh?

- Nuk e pi duhanin, - thotë Sonja.

Sërish krijon rrethin e kaltër nën tavan dhe e shikon se si humbet. Sikur nuk ngutet aspak dhe ka kohë me tepricë. Shumë, shumë kohë. Sonjën e përshkon një ndjenjë e çuditshme se duhet ta largojë shikimin nga ky veprim i lehtë. Kuptohet, kështu i krijon retë në tavan edhe kur merr në pyetje dikë në zyrën e tij. Pyet, fryn rrethin në drejtim të tavanit, e vëren dhe pret përgjigjen.

- Gjermanishtja jote, - thotë Ludvigu dhe përkulet paksa përmbi tryezë drejt saj, - është aq... si të them, elastike. Dhe e qartë, secilën fjalë e shqipton plotësisht qartë.

- Kam studiuar për mjekësi në Gradec. Universiteti *Karl-Frenzens*.

- O!

Mishkolnigu tha "O", por u duk i befasuar. Fytyrën ia përshkoi një buzëqeshje e këndshme, O-ja e tij ishte si ato retë, si rrathët, që i lëshonte nën tavanin e Kafenesë së Madhe, do të thotë "Theresienhof"-it.

- *Reichsuniversität*, - tha, - tani quhet kështu, emërtimet qesharake austriake i kemi hequr.

- Hequr, - pohoi me kokë dhe me nxitim. Babait të saj emri i universitetit *Karl-Frenzens* i dukej i shkëlqyeshëm, emër i vjetër dhe i respektuar.

- Por, i ndërpreva studimet, - tha Sonja.

- E pse?

Ajo nuk dëshironte të fliste për shkakun e ndërprerjes së studimeve dhe shtoi:

- Është luftë.

Mishkolnigu buzëqeshi:

- E pse të mos studiojnë njerëzit në kohë lufte, universitetet punojnë, fabrikat punojnë, gjithçka punon, jeta vazhdon përpara.

Vetëm tani, kur iu afrua e vërejtí se kishte pika të vogla ndërmjet dy syve, në fytyrë, dhe nëse e shikon mirë edhe në qafë. Qafë e lëmuar, gjermanishte elegante, vajzë elegante.

- Profesori ynë i gjermanishtes, - tha shpejt, për të mos iu përgjigjur pyetjes mbi studimin dhe shkakun e ndërprerjes së tij, - kishte studiuar në Frankfurt.

- Nuk ka rëndësi se ku ka studiuar profesori juaj.

Buzëqeshi dhe shpjegoi për çka bëhej fjalë.

- Bëhet fjalë për faktin se ju që e keni mësuar këtë gjuhë, e kuptoni më mirë fuqinë dhe bukurinë e saj. Ç'të them... jeni e freskët, në shqiptimin tuaj shihet përpikëria dhe freskia. Nuk do të më besosh; kur shkova në Gradec, kjo ndodhi diku fill pas atij skijimi, atje vijova kursin e gjermanishtes së pastër. Gjermanishtes së Gëtes, gjermanishtes së Shillerit. Para se të shkoja atje lart, punoja në shtypshkronjë, për çdo ditë kisha të bëja me gjuhën, me fjalën e shtypur, di çka është

gjuha, di çka është kultura. Nëse do të doja ta hiqja qafe dialektin tim të neveritshëm të Mariborit, do të duhej të bëja diçka.

Qeshi. Ishte qesharake që ai, Ludvig Mishkolnigu, familja e të cilit, që nga kohët e lashta ishte e vendosur këtu në skajin jugor të botës gjermane, mësonte t'i shqiptonte fjalët dhe fjalitë, siç i kishin shqiptuar Shilleri dhe Gëtja.

- Profesori na shpjegonte, - foli pa u matur Sonja, - se dialekti i gjermanishtes së Mariborit është mbetje e një dialekti bavarez. Paraardhësit tuaj, më duket, kishin ardhur nga Bavaria.

Ludvigu pushoi së qeshuri, sepse kjo nuk ishte qesharake, as e mençur, ishte marrëzi, krejtësisht budallallëk. Mbetje? Paraardhësit? E prej kah erdhën paraardhësit e saj, me gubere të qelbura nga moçalet ruse, prej atje u dyndën.

- Profesori yt ishte budalla, - tha qetë. - Edhe nëse ka studiuar njëqind herë në qytetin e Gëtes. A jep mësim ende në gjimnaz?

Sonja mohoi me kokë. Kjo bisedë me çaj përpara dhe në shoqërinë e rrathëve të tymit të cigareve nën tavan, në moment filloi të mos zhvillohej mirë. "Bibë e çmendur, po unë nuk erdha ta provokoj këtë njeri."

- Më duket se e kanë shpërngulur. Diku në Serbi, - mendoj.

- Atje edhe e ka vendin, - tha, - në plehrat e Europës.

Sonja shikoi njeriun para vetes dhe piu disa gllënjka çaj. Mishkolnigu e vështroi me kujdes disa çaste. Kur iu drejtua atje në rrugë, u skuq, e tani shikimi i saj po ikte, nuk mund ta shikonte në sy, bebëzat e saj ngjyrë kafe shëtisnin nëpër hapësirën e dritareve të mëdha,

atje diku përtej Dravës, në bregoren e gjelbër në anën e kundërt të lumit. Çka fsheh kjo? Mishkolnigu i njihte shikimet e njerëzve, shikimet që gënjejnë, shikimet që fshihen, shikimet që, të humbura, shëtisin nëpër hapësirë, shikimet që me dëshpërim kërkojnë pikën e mbështetjes si zgjidhje, që nuk ekziston askund. Në ata sy, mbi fytyrën me pikla askurrë nuk ishte një gjë e tillë, janë këta sy të virgjërisë së njomë, ata fshehin vetëm faktin se duan të ndërmjetësojnë për dikë, duan ta lusin për ndihmë, së shpejti do të shohim se çka dëshiron.

Sonja buzëqeshi përsëri, mirë e tha këtë, nuk është mendim i keq ai mbi plehun serb, do të duhej t'ia thoshte edhe ndokujt në zyrë. Ose, edhe më mirë, nëse bëhemi pak më vulgarë: në zorrën e trashë të Europës, vetëm shikojeni hartën, Serbia, që e shkatërroi Austrinë, është vërtet zorrë e trashë.

Ajo heshti. E donte profesorin e vet të gjermanishtes, admirimi i të cilit për gjuhën dhe kulturën gjermane nuk e ndihmoi. Ky Ludvigu dhe shokët e tij e hipën në tren, si edhe gati të gjithë profesorët dhe meshtarët dhe shumë të tjerë nga ky qytet. Në Serbi, nuk kishte gjë kundër Serbisë. Dhe njeriu me të cilin po fliste këtu, nuk ishte ai Ludeku i para pesëmbëdhjetë vjetëve, nuk ishte njëri prej të cilit do të mund të priste gjë. Kishte gabuar, me gjithë qejf do të ngrihej dhe të shkonte. Por, ligjërata mbi gjuhën nuk kishte marrë ende fund, Mishkolnigut i dukej se duhej t'ia shpjegonte vajzës disa gjëra.

- Që të më kuptosh: gjermanishtja e dialekteve është ende gjermanishte. Ne e kemi në gjak këtë gjuhë, kupton? Këtë e kemi në organizëm, na qarkullon nëpër

gjak, dhjetë gjenerata para meje kanë folur gjermanisht dhe gjuha kështu vjetrohët, bëhet sipërfaqësore. Edhe fjalë të huaja përzihen brenda. Për këtë arsye m'u desh ta spastroj te vetja. Më kupton?

Sonja mohoi me kokë, s'e kuptonte.

- Jemi komb i vjetër, kulturë e vjetër. E ju jeni komb i ri, ju mësoni shpejt. Do të na sillni freski, gjak të ri, brenda një gjenerate do të jeni gjermanë më të mirë seç jemi ne.

Sonja nuk dëshironte të bëhej gjermane më e mirë, as babai i saj. Sidoqoftë, tha: - Mendim interesant.

Këtë e tha vetëm ta linte të qetë, nuk kishte ardhur këtu për të dëgjuar shtjellime mbi gjuhën dhe gjakun e freskët dhe as për t'i admiruar rrathët e kaltër të tymit të cigares, që rrëshqisnin nga goja e tij. Dhe pohonte me kokë. Dhe me njerëzi ua kthente përshëndetjen oficerëve që kalonin pranë tryezës dhe e përshëndesnin me respekt *kavalier* Ludvigun, siç tha një zotëri i vjetër me pantallona dhe çizme kalorësi: Kavalieri Mishkolnig është sot në shoqëri të bukur, respekt! Nuk kishte ardhur që, në shoqëri të kavalierit pa uniformë, t'i përshëndeste parakaluesit, kryesisht oficerët me uniforma, që e kishin mbushur kafenenë.

- Auh, harrova plotësisht, - klithi, - babai të përshëndet.

Këtë e trilloi, një sprovë mjerane e fundit, për ta kthyer këtë njeri nga monologët e tij mbi gjuhën dhe kulturën. Dhe plehrat. Po ta dinte babai se rrinte në Kafenenë e Madhe, midis oficerëve gjermanë, do të dëshpërohej. Ludeku, do të thoshte, ishte djalosh krejtësisht në rregull derisa merrej me shtypshkronjën. Pastaj ia mbathi, së pari në Kulturbund, e pastaj në

Austri. Si është e mundur, do të thoshte, megjithëse disa herë e kishte thënë këtë, që këta njerëz u bënë derra të tillë? Ndoshta do të dëshpërohej, po ta dinte se ajo po rrinte me Ludekun dhe po i admironte rrathët e tymit, që ai dinte me aq shkathtësi, veç me gojë t'i shndërronte në rrathë.

- O, - thirri Ludvigu i kënaqur, - kjo më gëzon. Ende punon në spital?

- Ende, - pohoi Sonja me kokë, - në kirurgji.

- Oh, paska mjaft punë, pra, - tha dhe e shikoi me respekt.

- Mjaft.

Ludvigu heshti një kohë, sikur të mos e dinte, se a meritonte vazhdimi i bisedës me damën e re, që dukej qartë se e adhuronte, apo ndoshta më mirë ta ndërpriste me këtë çaj të ëmbël dhe të kalonte në konjak. Vendosi për konjak dhe me dorë i dha shenjë kamerierit, që vrapoi me një rubë të bardhë të nxjerrë rreth bërnylit.

Një kohë heshtën, si të mos kishin gjë të flisnin. Kur erdhi konjaku në tryezë, Ludvigu mjeshtërisht, me një lëvizje të butë e mori gotën në shuplakë, e shkundi lëngun e kuq në të, i mori erë dhe e provoi.

Sonjës iu duk, se këtë e bënte po aq mirë, ndoshta edhe më mirë sesa rrathët e kaltër.

- I mirë është, - tha papritmas në sllovenisht. - Pse po çuditesh, - tha, - mendon se kam harruar?

Sërish u përkul përmbi tryezë dhe me zë të ulët, si ta besonte shtoi:

- Sllovenishtja në punën time më ndihmon shumë.

Sonja ndjeu se nëpër shpinë i kaloi një djersitje e ftohtë. Në *punën* e tij. E, njëkohësisht e kuptoi se nuk i duhej të merrej më me rrathët, gjuhën dhe konjakun.

Këtu ishte për një çështje jetike. Dhe, ndonëse çështja ishte me seriozitet jetik, asaj i duhej të buzëqeshte.

- Kur u takuam në rrugë, - tha qetë dhe me buzëqeshje, - e ceka, se nuk bëhej fjalë për babain tim.

#### 4.

Tani Ludvigu heshti dhe e shikoi ftohtë. Kishte harruar çka kishin folur në rrugë, atëbotë vërtet kishte menduar se vajza do të ndërhynte për dikë, i njeh këto gjëra, i dukej se diçka të tillë i kishte thënë, por kishte harruar. Mbrëmë kishte menduar shpesh për ecjen e saj elastike nën atë fundin me kuadrate, për zërin e saj të ëmbël, e tani mendonte se sa elastike dhe e freskët është gjermanishtja e saj, gati si edhe vetë ajo. Ja tani, gjithmonë e njëjta gjë, a nuk mundet në këtë kohë dhe qytet të mallkuar - le të jetë edhe njëqind herë qyteti i tij - të kënaqesh me një çast të qetë, a duhet gjithnjë të jesh në kujdes?

- Për kë bëhet fjalë? - tha ftohtë Ludvig Mishkolnigu, tani nuk ishte më Ludek, ishte vetëm polic, polic i një lloji tejet të rëndësishëm. Por, pikërisht për faktin se ishte polic, Sonja po fliste me të, pikërisht për këtë arsye kishte vrapuar pas tij në rrugë. Atë ditë ishte me uniformë, e tani ishte civil. Sonja nuk e dinte që nuk ishte polic i thjeshtë, Mishkolnigu ishte oficer SS. Momentalisht në dispozicion të shërbimit të sigurisë, SD, që në këtë qytet kryente detyra jashtëzakonisht të rëndësishme. As atë nuk e dinte, por do ta zbulonte, se policët ecnin përreth edhe me rroba civile. Kur janë në punë, janë me uniforma, me uniforma të hirta të

repartëve SS-e, kështu të gjithë ata, që janë në policinë e sigurisë, janë edhe SS-ë. Por, Sonja nuk i dinte ende të gjitha këto, me shpresë të madhe e kishte takuar Ludekun, burrin e ri, që e kishte nxjerrë dikur nga bora.

- Gabimisht e kanë arrestuar një mik timin, - shpërtheu me vrull nga ajo diçka, që e kishte ndrydhur kohë të gjatë, që nga atëherë, kur vrapoi pas tij në rrugë.

- Gabimisht?

- Ndoshta e kanë ngatërruar me dikë tjetër.

- Kuptohet se gabimisht. Gjithmonë është gabimisht. Në mos është edhe ai farë profesori?

- Jo, është asistent në Universitetin e *Lublanës*, është gjeodezist.

- I dashuri yt?

- Miku, - tha Sonja me hezitim.

- Po e kuptoj, - është dashnori yt.

Sonja shikon çajin e ftohur në tryezë, kishte mbetur shumë, do ta pijë me ngulm deri në fund, ah, sa do të dëshironte që të përfundonte sa më parë kjo bisedë.

- Vetëm për këtë më ndalove në rrugë, që të bëhesh lypsare për dashnorin tënd. Si e ka emrin?

- Valentin. Valentin Gorjan.

Ludvigu nxjerr nga xhepi fletoren e shënimeve dhe shkruan emrin e tij. Me bisht të syrit Sonja vërejtë se tryezat e tjera shikonin në drejtim të tyre; dikush qeshi me zë të mesëm. Kolegu i tyre nuk është vetëm kavalier, por edhe në kafene punon. Shërbimi i tij është i tillë, që duhet të punojë edhe vonë pasdite, edhe në kafene, edhe në shoqëri të bukur. E shkroi edhe numrin e vet të telefonit, e grisi fletën dhe ia dha përmbi tryezë.

- Tani kjo çështje është zyrtare, - i tha.

Pa lëvizur shikonte kokën e saj të ulur, i kërkoi sytë e saj, që endeshin në hapësirat e dritareve të mëdha, pas të cilave shkëlqente dielli i ngrohtë i pasdites.

- Sidoqoftë, më ke befasuar paksa, - tha Mishkolnigu.  
- Këtu nuk ka asgjë personale. Vetëm ajo që është e ligjshme, vetëm aq.

Edhe ai me gjithë dëshirë do ta përfundonte këtë bisedë. Ishte ai vetë fajtori, që u përzje në këtë takim, që në rrugë, por tash ishte ç' ishte. Askujt nuk i ka asgjë borxh, e më së paku kësaj *fragile*, që mendon se do ta futë në ndonjë budallallëk, e për çka, për çka, që ta nxjerrë dashnorin e saj nga burgu?

- Më merr në telefon pas dy ditësh, - tha prapëseprapë, - do të interesohem.

Kur u çuan e ndihmoi të vishte xhaketën, ndjeu se i dridheshin krahët.

- Por, të kuptohemi, - i tha me zë të ulët, gati me pëshpëritje në vesh. - Duhet të më marrësh. Nëse nuk më merr, do të kërkojmë.

E tha dhe buzëqeshi shkurt, që ta kuptonte vajza: ai do ta kërkojë, do të dëshironte të takohej sërish me të. Mund ta kuptonte edhe si kërcënim, do ta kërkojnë, sepse ishte e afërt me njeriun, që e kishin futur në burg. Por nuk e kuptoi ashtu, në fakt ajo nuk kuptonte asgjë tjetër përpos se ky burrë ka pushtet mbi Tinen e saj, mund ta ndihmojë. Ndonëse tani kishte pak pushtet edhe mbi të, por vetë ishte futur në një pozitë të tillë.

Sonja ngre shikimin dhe e shikon me lutje.

- Nuk do t'i bëni gjë të keqe, - pëshpëriti.

- Natyrisht jo, - thotë me sjellje galante, por pakëz me përqeshje Ludvig Mishkolnigu, - nëse dama e re, të cilën dikur e nxora nga bora, kërkon kështu.

Dhe mendon se gjë më të çmendur nuk kishte dëgjuar një kohë të gjatë.

Deklarata e saj, madje, e këndelli paksa, i erdhi të qeshte, me plot dëshirë do të thoshte, po kujt i bëjmë ne gjëra të këqija?

Por Sonja e befasoi edhe një herë. Si t'ia kishte lexuar mendimet.

- Asgjë nuk kërkoj, - pëshpëriti me nxitim mu në fytyrën e tij, afër gojës së tij me aromën e tymit të cigareve dhe rrathëve të kaltër rrëshqitës, - e si mund të të kërkoj gjë, kush jam unë që të kërkoj?

I foli me vrull, me gjysmë zëri, para të gjithë oficerëve, tani shumë syresh shikuan drejt tyre.

- Asgjë nuk kërkoj, - tha gati me zë. - Unë po të lutem. Të lutem.

## 5.

Obersturmbführer Ludvig Mishkolnigu ecte nëpër “Adolf-Hitler-Platz” dhe u nis nëpër “Herrengasse” drejt banesës së vet. Freskia e erës së mbrëmjes së vjeshtës së hershme ia fladiste fytyrën, paksa të skuqur nga ngrohtësia e shumë trupave dhe tymit të cigares në kafene, e paksa edhe nga frymëmarrja e Sonjës, që e kishte ndier pak përpara në fytyrën e tij, nga shikimi i saj, naiv, apo më mirë shikimi i virgjër, kush shikon ashtu, nuk mund të fshihte gjë në shpirt, sepse sytë janë pasqyrë e shpirtit, nga ajo shprehja e saj: *të lutem*. Një *të lutem* e tillë nga një damë e re simpatike, me siguri e shqetëson pak njeriun, por nga kjo njeriu ndihet disi mirë. E ndiente veten mirë, ky ishte qyteti i tij, tani

ngadalë po bëhej edhe më i sigurt siç e dëshironte gjithmonë, me rreshta të dendur mirë, *mit ruhig festem Schritt*, murmuroi, ose këndoi, këtë e këndonin në *SS-Junkerschule: mit ruhig festem Schritt*, ëndërronin për një Europë të re, që do të jetë gjermane dhe e pamposhtshme. Ende është e tillë, ndonëse disa gjëra nuk shkonin më siç do të duhej, e edhe qyteti i tij është në Europën e re. Nëse mendon për këtë, mund të jetë i kënaqur, pavarësisht nga pengesat që do të duhet të tejkaloheshin. Edhe gjermanishtja e jashtëzakonshme e Sonjës ia shtoi kënaqësinë. Gjithmonë ishin njerëz të mirë, në shumicën e rasteve njerëz të mirë në secilin shtet; në Austri, në Jugosllavi e edhe në Reich janë në rregull, kryejnë punën e tyre ashtu siç duhet, babai i saj është mjek, mjekët na nevojiten. Ajo që u mungonte, është vetë kjo që po ndodh sot, tani po bëhen tanët, pjesë e kulturës së madhe gjermane. E njihte babain e saj, posa ajo ia përmendi emrin iu kujtua mirë, doktor Belaku, mjeku dhe deri para një viti atdhedashësit, çfarë fjale boshe, në veçanti nëse asaj i shton fjalën slloven, atdhedashës slloven, njerëzit që deri dje në festat e tyre atdhedashëse këndonin këngë atdhetare, që ngrinin plehrat sllave, serbe e ruse, poshtëronin bashkëqytetarët e tyre gjermanë dhe talleshin me sllovenishten e tyre, *do të ecin me kokë për tokë* - e tani shih, çfarë gjermanishte flasin fëmijët e tyre; Shilleri do të gëzohej. Edhe atdhedashuria e tyre disi ka filluar të avullohet, brenda natës u bënë qytetarë besnikë gjermanë. Gjithçka kaloi mirë, gati shkëlqyeshëm. Vitin e fundit, që kur filluan të bien bombat në qytet, paksa më keq, shumë më keq. Entuziazmi fillestar u shua pak. Por gjërat më të rëndësishme këtu, së paku

në këtë qytet, janë kryer. Takimi me Sonjën e mbushi me kënaqësi, do të shikojë si ishte puna me atë... si e pati mbiemrin, Gorjanc apo Gorjup. Nuk dëshiroi që ajo t'i shpjegonte gjë, pasi e dinte se çfarëdo të thoshte, e dinte atë këngë: gabimisht, krejt rastësisht e kishte revolen në xhep, materialin propagandistik komunist dikush ia kishte futur pa dije në çantë, ishte i dehur, kur tha pas banaku le të shkojë në djall rajhu, e dinte atë këngë, të gjithë ishin të pafajshëm dhe të gjithë arrestoheshin gabimisht. *Me hap të qetë, por të vendosur*, po, por edhe me grusht të hekurt, siç kishte thënë *gauleiteri* tyre kur kishte ardhur në Marburg an der Drau dhe kishte marrë udhëheqjen e drejtorisë civile, ua kishte thënë qartë, nëse do të ketë nevojë.

Sidoqoftë, do të shihte për çka bëhej fjalë, me sa i kujtohej, në mesin e të pandehurve, që ishin në kompetencën e tij, do të thotë në përpunimin e tij, ky Gorupi, apo sido që e kishte emrin, nuk ishte. Me siguri ishte në dorën e Hoshbaurit. Të vetët i njihte, jo vetëm sipas emrit, por edhe farefisnin e tyre deri në brezin e pestë, edhe dashnoret e tyre. Në fakt, tani e njihte edhe dashnoren e këtij Gorjanci, Sonja e ka emrin, kur ishte vajzë e vogël e kishte nxjerrë të lagur nga bora, edhe tash do ta nxirrte. Thënë të vërtetën, me gjithë dëshirë.

## 6.

Ndali në skaj të parkut. Në katin e dytë, në dhomën e së ëmës, drita ishte e ndezur. E priste.

Qëkur nuk është më babai, ajo e pret për çdo natë, siç priste burrin e saj. Krepa kam për ty, bir. Nuk i pëlqente

ajo fjali, pas detyrës së rëndë, që kryente gjatë ditës, në mbrëmje nuk i pëlqente ta thërriste bir, siç i thoshte kur ishte i vogël. Më së shumti do t'i pëlqente të kalonte pranë dhomës së saj në majë të gishtave, të shtrihej, të dëgjonte ndonjë këngë, të lexonte ndonjë libër. Por kjo nuk ishte e mundur: mbrëmë kur erdhi nga zyra, i hoqi çizmet që në shkallë, e hapi në heshtje derën - në paradhomë as që e ndezi dritën - dhe me çorape u nis drejt dhomës së vet. Por, nëna, edhe përkundër moshës së vet, kishte dëgjim të shkëlqyeshëm, hapi derën, ndezi dritën dhe e shikoi çuditshëm.

- Ç'është me ty? - i tha. - Ndoshta nuk je i dehur.

Mohoi me kokë, tha se nuk dëshironte ta pengonte. Por, nuk e pengonte, mezi priste çdo natë që ta shihte, se asnjëherë nuk ishte në shtëpi.

- E di se kam shumë punë, nënë.

- E di, - tha nëna, - por unë të pres aq me padurim. Do të mund të dëgjoni ndonjëherë së bashku *Veronika, der Lenz ist da*.

- Nuk më pëlqen ajo këngë, - u përgjigj pa vullnet.

- Dikur të pëlqente, të gjithë e dëgjonim.

I lëshoi çizmet dhe e zbërtheu rripin me revole. Nëna e përcolli me shikim.

- E, çfarë ke? - tha paksa me nervozizëm. - Pse po më shikon ashtu?

- Ti e di mirë se çfarë kam, - shfryu dhe i vuri duart në bel.

- Më thuaj, çfarë?

- Ishe te dashnorja, - tha. - Pse nuk i tregon nënës sate? Nuk kam asgjë kundër, vetëm mund të ma prezantosh.

- Nënë, - tha qetë, aq sa ishte e mundur. - Nuk isha te dashnorja dhe mos fol marrëzira. Isha në punë, i zbatha çizmet, sepse mendova se po flije, nuk desha të të zgjoja.

- Ti e di mirë se unë kurrë nuk fle; gjithmonë të pres, - i tha.

Hyri në dhomën e vet dhe mbylli derën me zhurmë. Priti pak kohë, pritë që ajo të shkonte. Por ajo nuk shkoi, pas derës dëgjoi shushuritjen e rrobave të saj të gjumit.

Pastaj ajo këndoi me zë të ulët:

*Veronika, der Lenz ist da,  
die Mädchen singen Trallala.*

- Nënë, shko të flesh, - i tha.

Nëna nuk iu përgjigj, por pas pak i foli me zë të thyer, gati me dënësë:

- Krepat janë në sobë, marmelata në dollap.

E hapi derën. Ajo qëndronte aty dhe mezi i mbante lotët. Mendoj, se ishte aq e vetmuar, qëkur nuk ishte babai, aq e vetmuar. E përqafoi. Shkoi në kuzhinë dhe filloi të hante krepa, ndonëse nuk kishte aspak uri. Nëna ishte ulur në karrige, duart i mbante në prehër dhe e shikonte e kënaqur.

Kjo ndodhi mbrëmë. Sonte vërtet nuk dëshironte krepa me marmelatë. Vendosi të shëtiste edhe pak, ndërkohë nëna ndoshta do të flinte, nganjëherë edhe e zinte gjumi. Në mëngjes do t'i kërkojë falje, se nuk i kishte ngrënë, do t'i hajë në mëngjes, edhe për mëngjes janë të mira. Atë mbrëmje dëshironte edhe pak ajër të freskët vjeshte, shëtitje nëpër qytetin e çliruar që i ishte

bashkëngjitur atdheut gjerman. Mendoj të kthehej në kafene dhe në shoqëri të miqve, që aty nuk mungon kurrë, të ndante mendimet e veta të gëzueshme. Herëherë aty vjen edhe Hans Hoshbauri, pi dhe i lëshohet humorit prej idioti: Të ka lejuar nëna të dalësh? Hansi e pyet pse jeton ende me nënën, do të mund ta gjesh banesën tënde. Dhe të martohesh. Ludvig Mishkolnigu qesh dhe thotë, unë jam i martuar me atdheun. Ndonëse nuk i duket për të qeshur, Hansi është vartësi i tij në punë dhe ia lejon vetes një humor të tillë. Është i shëndoshë, ha tepër, ndonëse në këtë detyrë nuk do të duheshin njerëz të tillë që hanë e pinë aq shumë.

Portani mund të shkonte te shokët në “Theresienhof”, Hansi është në Vjenë, është duke zgjidhur një çështje të ndërlikuar me komunistët e këtushëm dhe austriakë. Nuk i duhej të dëgjonte thumbimet e tij të marra. Do të mendohej të fliste me kameradët e vet; si është puna në front, disa prej tyre kanë qenë në Afrikë, në Skandinavi, në Poloni. Burra të guximshëm. Nganjëherë dëshironte që edhe ai të shkonte në fushëbetejë, në zhurmën e shpërthimeve dhe fitoreve. Por atdheu do që ai të jetë këtu, në qytetin e vet, edhe këtu zhvillohet beteja për Gjermaninë dhe Europën e re.

Nuk shkoi në kafene. Parkun e kishte më afër, parandjenja e gjelbërimit të errët e tërhoqi ndër drunj të vjetër. Shkoi drejt *Tri hurdhave*, një kohë shëtiti andej-këndej dhe nuk e kuptoi sesi u gjend para hyrjes në zyrë, vetë këmbët e gjetën rrugën për atje. Roja në hyrje e përshëndeti, te portieri po fliste njëra nga daktilografistet kujdestare. Foli diçka rreth mbrëmjes së bukur dhe mori çelësin e zyrës së tij, në fakt jo

vetëm atë, por edhe të zyrës së Hansit. Do të shikojë dosjen e Gorjanit.

7.

Sonja qëndron pranë dritares në dhomën e vet.

Nga përdhësja dëgjon kërcitjen e enëve, nëna dhe babai po darkonin, ajo sonte nuk do të hante, nuk kishte uri. I dëgjon zërat e tyre, flisnin me zë të ulët mbi çështjet e përditshme, babai fliste për spitalin, ka punë të rëndë, ka pak mjekë, një pjesë të personelit e kanë përjashtuar, gjithçka mungon. Është luftë, edhe ushqim ka më pak, ata vetë shkojnë disi, babai fiton me kuponë më shumë se të tjerët, për mjekët duhet treguar kujdes. Edhe të sëmurët nga fshatrat i sjellin diçka, miell, ndonjë copë mishi të tharë; sot në shtëpi ka vezë të freskëta.

- Zonja Katica i ka sjellë, zonja Modrinjak, ti e njeh atë.

Zonja Katica Modrinjak nuk është paciente, është infermiere që punon në Ptuj, në spitalin e atjeshëm. Njihen mirë me babain, e viziton atë në spital, edhe te ne vjen. Ndonjë pasdite rrinë vetëm gjatë në dhomën e pritjes dhe bisedojnë.

Sonjës i duket e pazakonshme, as nëna nuk është e pranishme në ato raste kur babai dhe zonja Katica futen thellë në bisedë.

- Për çfarë bisedojnë aq gjatë? - kishte pyetur njëherë Sonja.

- Çështje zyrtare, - i ishte përgjigjur e ëma.

Për Sonjën kjo ishte e çuditshme, sepse për to mund të flisnin në spital, apo në Ptuj, kur babai shkonte të vizitonte ambulancën e atjeshme. I dukej se di diçka rreth fshehtësisë që kishin babai i saj dhe zonja Katica. Vërtet sjell vezë, por ndonjë gjë edhe merr nga shtëpia. Njëherë e pa se si babai i saj nxori nga çanta e vet fasha, shishe me dezinfektues, gjilpëra e pinca, edhe disa vegla kirurgjikale dhe i futi në një thes pëlthure. Kur iku zonja Katica, këto gjëra nuk ishin më në paradhomë. Ç'i duheshin zonjës Katica ato gjëra, kur ajo vetë punonte në ambulancë, a thua nuk mund t'i çonin me automobil?

Por sot Sonja nuk ishte duke menduar lidhur me bisedat e babait me zonjën Katica, e po ashtu nuk i interesonte se çka kishte sjellë zonja Katica në shtëpi dhe çka kishte marrë prej saj.

- Do të përgatis vezë, - tha nëna, - ha veç pak, mjaft ke rënë në peshë.

- Nuk do të ha darkë, nuk kam uri.

- Çka ke Sonja? - i tha nga pas, ndërsa ajo po shkonte shkallëve në dhomën e saj. - Ç' është me ty, kohët e fundit nuk ha gjë?

*Çka ke ti, asgjë s'kam, veç në zemër dhimbje kam.* Ndodhet pranë dritares. Është mbrëmje, qyteti është i qetë. Atje poshtë është rreshti i gështenjave, është i zbrazët. Nganjëherë përgjatë mbrëmjeve të ngrohta aty qëndrojnë dhe bisedojnë njerëzit. Nga malet e afërta, me hapa të lodhur, me çanta në shpinë kthehet në shtëpi familja. Në darkë nënat i thërrasin fëmijët, nëpër rrugë dëgjohet zhurma e një motoristi, te françeskanët ra nëntë herë kambana. Në dhomën e saj, mbi tryezë ndodhej letra, që ia kishte shkruar të dashurit në